



## Nuk ka martesë, përveçse me kujdestar

Ebu Musa Eshariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Nuk ka martesë, përveçse me kujdestar."

[Ky hadith është sahih.] [E shënon Ibn Maxhe.]

Hadithi tregon se kujdestari duhet të merret në konsideratë gjatë kontratës së martesës dhe se prania e tij është kusht për vlefshmërinë e saj. Pra, martesë nuk është e vlefshme përveçse me praninë e kujdestarit, i cili e merr përsipër kontratën e martesës. Kujdestari kushtëzohet të jetë një person ligjërisht përgjegjës, i cili duhet të jetë mashkull dhe të jetë i arsyeshëm, që t'i dijë dobitë e martesës, si dhe kujdestari e gruaja nën kujdestarinë e tij duhet të jenë të së njëjtës fe (islame). Një person që nuk i posedon këto cilësi, nuk është i kualifikuar për të qenë kujdestar në martesë. Nëse një gjë e tillë është e pamundur, atëherë sundimtari bëhet kujdestar i saj.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/58066>

